



Republika e Kosovës — Republic of Kosovo
Komuna e Hani i Elezit — Municipality of Hani i Elezit



05.nr. 4874 22

Data: 04 / 07 / 2022

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligji për Arsimin në Komunat të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 30 / 15 Qershor 2008) të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimi Administrativ (MASHTI) nr. 03/ 2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë këtë:

K O N K U R S - P L O T Ë S U E S

**PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR NË KOMUNËN
HANI I ELEZIT PËR VITIN 2022/2023**

Vendet e lira për regjistrimin në vitin 2022/2023	
Grupmosha	Institucioni Parashkollor "ARDHMËRIA"
09muaj >3 vjeç	8 -Fëmijë
3>4 vjeç	12 -Fëmijë
4>5 vjeç	0-Fëmijë
Gjithësej	20 - Fëmijë

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);
- Dokumentet personale të prindërve (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Vërtetim vendbanimi nga bashkësia lokale;
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP, bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligjit nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më 04.07.2022 deri më datën 15.07.2022;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës çdo ditë pune prej orë 09:00 deri në ora 15:00;
- Shpallja e rezultateve bëhet më datën 22.08.2022 në institucionet parashkollore përkatëse;
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në institucionin parashkollor përkatës në afat prej tre (3) ditëve pas datës së publikimit të rezultateve;
- Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të ushtrojnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë, në afat prej tetë (8) ditëve; DKA nuk shqyrton asnjë ankesë, nëse e njëjta nuk është shqyrtuar me shkrim nga IP përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës — Republic of Kosovo
Komuna e Hani i Elezit — Municipality of Hani i Elezit



05.Nr. _____ 22

Data: 04.07.2022

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), në ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr. 02/L-52, Ligji nr.03/ L-068, Ligji nr.04/ L-32 dhe Ligji nr.04/L-138), në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/ 2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Statutin e komunës Hani i Elezit, nr.01/7703, neni 63, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr këtë:

V E N D I M

(Për kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionin parashkollor publik)

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të komunës së Hanit të Elezit mund të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP) të Komunës së Hanit të Elezit;
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukurore të Institucionit parashkollorë;
3. Moshë minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP e përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetin profesional dhe infrastrukturor, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marrë parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marrë parasysh datën 1 Shtator.
4. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	Pikët
1	Fëmijët bonjak pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjak pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK -së nëse njëri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK -së nëse asnjëri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
12	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK -së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK -së nëse njëri prind punon	15
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK -së nëse asnjëri prind nuk punon	10
15	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	20
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	40
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	30
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	25
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve mbi 1000 euro)	20
20	Fëmijët e prindërve që tashmë e kanë një fëmijë vijues në IP	10

5. Nga pagesa lirohen (Fëmijët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, fëmijët e veteranëve të luftës, fëmijët e familjeve me asistencë sociale, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, fëmijët e prindit vetmbajtës, fëmijët që jetojnë me një prind, fëmijët që vijnë nga grupet e rrezikuara.
6. Të gjitha statutet e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante;
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

Institucionit parashkollorë "Ardhmëria"

Hani i Elezit

